



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**УСТАВНИ СУД**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

---

Prishtinë, më 24 janar 2012  
Nr. ref.: RK189/12

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**Rastin Nr. KI 54/11**

Parashtruesi

**Adem Qamili**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. Nr.  
11/2002, të 6 shkurtit 2002**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar  
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Ivan Čukalović, gjyqtar  
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe  
Iliriana Islami, gjyqtare

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Parashtrues është Adem Qamili, nga Komuna e Vitisë.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. Nr. 11/2002, të 6 shkurtit 2002.

## **Objekti i çështjes**

3. Parashtruesi pohon se ka pasur shkelje të nenit 22, paragrafit 2 [i cili parashikon zbatimin e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, kryesisht paragrafin 1 të nenit 6], nenit 24 [Barazia para Ligjit], nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenit 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

## **Baza juridike**

4. Kërkesa është e bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet 46, 47, 48 dhe 49 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe në rregullin 56 (2) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatë**

5. Parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) më 21 prill 2011.
6. Më 21 prill 2011, Kryetari e caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Snezhana Botusharova, prof. dr. Enver Hasani dhe dr. Gjyljeta Mushkolaj.
7. Më 29 nëntor 2011, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë për papranueshmëri të kërkesës.

## **Përmbledhje e fakteve**

8. Më 25 korrik 2001, Gjykata Komunale në Viti, nëpërmjet Aktgjykimit C. Nr. 53/2001, e konfirmoi të drejtën paraprake të parashtruesit për ta blerë ngastrën kadastrale nr. 3089/1 në vendin e quajtur "Sello-Oborr", një shtëpi dhe oborr me sipërfaqe prej 0.02,20 ha. Gjatë marrjes së këtij vendimi, gjykata anuloi një kontratë formale të pavërtetuar, të 30 prillit 2001, me anë të së cilës J.S., përfaqësues i autorizuar dhe kujdestar i pronës për trashëgimtarët e tjerë, ia shiti N.A.-së këtë pronë kadastrale.
9. Gjykata Komunale e urdhëroi, ndër të tjera, J.S.-në që ta lidhte kontratën për shitje të pronës kadastrale me parashtruesin dhe ta vërtetonte atë në Gjykatën Komunale brenda 15 ditëve, përndryshe do të ishte objekt i përmbarimit të detyrueshëm. Gjykata Komunale tha se sikur J.S.-ja të mos e kishte respektuar afatin e caktuar, ky aktgjykim do të kishte shërbyer si bazë për ta regjistruar parashtruesin si pronar të pronës në regjistrin pronësor.
10. Gjykata Komunale e urdhëroi N.A.-në të pajtohej me bartjen e të drejtës pronësore për ngastrën e kontestuar kadastrale.
11. Më 23 tetor 2001, Gjykata e Qarkut në Gjilan, me Vendimin AC. Nr. 128/01, e refuzoi ankesën e J.S.-së dhe N.A.-së, dhe e konfirmoi Aktgjykimin C. Nr. 53/2001.

12. Më 6 shkurt 2002, Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktgjykimin Rev. Nr. 11/2002 e miratoi revizionin e J.S.-së dhe N.A.-së dhe e anuloi Vendimin e Gjykatës së Qarkut në Gjilan, AC. Nr. 128/2001, dhe Vendimin e Gjykatës Komunale në Viti C. Nr. 53/2001. Gjykata Supreme tërësisht e refuzoi si të pabazë kërkesëpadinë e parashtruesit lidhur me konfirmimin e të drejtës paraprake për blerjen e pronës së paluajtshme, të regjistruar si ngastra kadastrale Nr. 3089/1, në vendin e quajtur "Sello-Oborr" dhe e anuloi kontratën e pavërtetuar të 30 prillit 2001.
13. Pas shqyrtimit të aktgjykimit të ankimuar, Gjykata Supreme, në përputhje me dispozitën e nenit 386 të Ligjit për procedurën kontestimore, Gazeta Zyrtare e RSFJ-së Nr. 4/1977 (në tekstin e mëtejme: LPK), konstatoi që revizioni ishte i bazuar për shkak të zbatimit të gabueshëm të së drejtës materiale në këtë rast.
14. Gjykata Supreme vendosi që sipas nenit 4, paragrafit 2, të Ligjit për bartjen e pronës së paluajtshme, Gazeta Zyrtare e Serbisë Nr. 43/81, 24/89, 30/89 dhe 40/89 (në tekstin e mëtejme: LBPP), kontrata që nuk është hartuar në përputhje me nenin 4, paragrafin 1, të LBPP-së nuk do të ketë efekt ligjor. Në këtë rast, kontrata ndërmjet palëve nuk ishte vërtetuar nga gjykata, prandaj nuk ka efekt ligjor, kështu që konsiderohet pa fuqi ligjore, dhe konkluzioni i saj nuk e parashikonte as të drejtën paraprake për blerje të pronës. Në përputhje me nenin 26, paragrafin 2, të LBPP-së, padia mund të ushtrohet brenda një viti nga data e lidhjes së kontratës, por në këtë rast nuk kishte kontratë të vlefshme. Prandaj, Gjykata Supreme konstatoi që gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e shkallës së dytë e kanë zbatuar gabimisht të drejtën materiale.
15. Gjykata Supreme gjithashtu konstatoi që e nxori këtë vendim sepse, siç shihet në shkresat e lëndës, paditësi nuk e kishte depozituar çmimin e pronës së paluajtshme në kohën e parashtrimit të padisë dhe nuk e bëri këtë as gjatë kohës që procedura ishte në shqyrtim e sipër në gjykatën e shkallës së dytë, e kjo ishte në kundërshtim me paragrafin 2 të nenit 26 të LBPP-së.

### **Pretendimet e parashtruesit**

16. Parashtruesi pohon se kur Gjykata Supreme e Kosovës në Aktgjykimin e vet Rev. Nr. 11/2002, të 6 shkurtit 2002, padrejtësisht e zbatoi LBPP-në, ajo ia shkeli disa të drejta kushtetuese: të drejtën për barazi para ligjit, të garantuar me nenin 24 të Kushtetutës; të drejtën për gjykim të drejtë, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës; të drejtën për mbrojtje gjyqësore, të garantuar me nenin 54 të Kushtetutës; dhe të drejtat e tij të garantuara me nenin 22 të Kushtetutës sepse nuk ishte respektuar e drejta e tij për gjykim të drejtë sipas nenit 6, paragrafit 1, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

### **Vlerësimi për pranueshmëri**

17. Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë, dhe të specifikuar më tej në Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe në Rregullore të punës.
18. Nga dokumentet në kërkesë shihet se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Ac. Nr. 128/2001, ishte miratuar më 6 shkurt 2002, pra para hyrjes së Kushtetutës në fuqi (Kushtetuta hyri në fuqi më 15 qershor 2008). Në faqen 6 të kërkesës së vet, parashtruesi thotë se Gjykata nuk funksiononte në kohën kur e kishte marrë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme.

19. Gjykata konsideron se nga organet publike të Republikës së Kosovës mund të kërkohet të përgjigjen vetëm për faktet dhe aktet që kanë ndodhur pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës. Si rrjedhojë, Gjykata nuk mund ta shqyrtojë një kërkesë që ka të bëjë me ngjarjet që kanë ndodhur para hyrjes në fuqi të Kushtetutës (shih Aktvendimin e Gjykatës për Papranueshmëri në Rastin Nr. 18/10, Denic dhe të tjerët, të 17 gushtit 2011).
20. Prandaj, rezultojnë që kërkesa është e papranueshme në përputhje me rregullin 36.3 (h) të Rregullores së punës, i cili thotë që kërkesa po ashtu mund të konsiderohet e papranueshme nëse “kërkesa nuk është *ratione temporis* në pajtim me Kushtetutën”.

### PËR KËTO ARSYE

Në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës dhe rregullit 36.3 (h) të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese njehzëri

### VENDOSI


- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit; dhe
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtari raportues**



Kadri Kryeziu, Zëvendës kryetar

**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**



Prof. dr. Enver Hasani